

ERIKETA KAMBO

**NDRYSHIMET NË SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR
NË PRAG TË “REVOLUCIONARIZIMIT TË SHKOLLËS”
(1966-1968)**

Mesi i viteve 60-të shënoi futjen në fazën e “revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit”, si u quajt atëherë, gjatë të cilës ndodhën zhvillime të rëndësishme që prekën gjithë sistemin e edukimit dhe padyshim shkollën si baza e tij.

Shkolla shqiptare ishte dhe do të mbetet një shkollë me orientim të theksuar politik. Tashmë që shumë probleme të zhvillimit në gjerësi ishin futur në rrugën e zgjidhjes, do të tërhiqte vëmendjen në punimet e tij, Kongresi i V-të i PPSH në nëntorin e vitit 1966, “krijohen mundësi për t’u thelluar më shumë në forcimin e cilësisë dhe të përmbajtjes komuniste të gjithë punës arsimore e kulture”¹. Nga kjo pikëpamje, sipas konceptit të partisë-shtet, në kushtet e reja ishte më se “e domosdoshme të bëhej revolucionarizimi mëtejshëm i arsimit dhe i shkollës” që presupozonte një proces gjithëpërfshirës të përqendruar në ndryshime të rëndësishme “në vetë sistemin arsimor, brendinë e punës mësimore edukative si dhe metodat e mësimin dhe të edukimit”².

Ajo iu nënshtrua një reforme të re, shumë më të thellë e komplekse, me diapazon të gjerë veprimi dhe ndikim të fuqishëm në zhvillimin e saj të brendshëm dhe më gjerë, në atë të shoqërisë shqiptare të kohës. Nisur nga këndvështrimi i interesave të tij, shteti komunist u fokusua gjithnjë e më shumë në problemet e përmbajtjes së shkollës, me pikësynimin e forcimit të partishmërisë dhe tendenciozitetit të saj klasor.

* * *

Diskutimet për sistemin arsimor

Vitet 1966-1968 përfaqësojnë një periudhë të parë gjatë së cilës u hodh ideja e reformës dhe u përpunuan linjat themelore të platformës

¹ *Kongresi i Pestë i PPSH* (përmbledhje materiale), Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1969, f. 145.

² *Po aty.*

teorike. Analiza e plotë e kësaj periudhe kërkon një qasje komplekse dhe të thelluar por, në caqet e një artikulli mund të rilevohen vetëm disa nga momentet kyçe. Gjatë saj u hapën diskutime dhe u ndërmorën masa të reja, lidhur me ndryshimet në sistemin arsimor. Zhvillimet në këtë fushë u konceptuan si thellim i reformës të mëparshme për riorganizimin e shkollës, që gradualisht do të përgatiste terrenin, për zbatimin në praktikë të çështjeve që shtronte “revolucionarizimi” i saj.

Realizimet gjatë periudhës së riorganizimit të shkollës shërbyen si një faktor shtytës dominant me ndikim në përsheptimin e procesit të ndryshimeve që pasuan dhe që natyrisht u kryen nën drejtimin dhe tryshinë e faktorit politik. Ajo çka do ta përforconte idenë e nevojës së zhvillimeve të reja edhe në sistemin arsimor, do të ishte fakti se me gjithë përpjekjet e bëra për një varg arsyeshe objektive dhe subjektive, masat e marra deri në këtë periudhë nuk patën impaktin e pritur. Duke qenë se në fokusin e shtetit ishte synimi i përmirësimit të sistemit arsimor ekzistues, ai ishte i interesuar të mos prishej baraspesha e krijuar por të bëheshin vetëm korrigjime të pjesëshme në kahjen që këtij të fundit i interesonte.

Pretendohej që, me ndryshime të pjesshme të arrihej një rritjen e cilësisë të procesit mësimor-edukativ, për përgatitjen e “një brezi të ri revolucionar” si dhe e specialistëve e punëtorëve të kualifikuar në përmasa të mjaftueshme, për të përballuar nevojat në rritje të ekonomisë dhe të kulturës së vendit. Ndryshimet do të konsistonin para së gjithash me njohjen e të rinjve me veprimtarinë prodhuese që në bankat e shkollës, vendosjen e raporteve “më të drejta” midis arsimit të përgjithshëm dhe atij të ulët e të mesëm profesional, gjetjen e hapësirave të reja nëpërmjet shfrytëzimit efikas të kapaciteteve të këtij sistemi, për përgatitjen e sa më tepër punëtorëve të kualifikuar në shkollat e rregullta dhe sistemin pa shkëputje nga puna, etj.³

Sipas objektivave të përcaktuara në planin e katërt pesëvjeçar, në shkollat e mesme të përgjithshme, të mesme profesionale dhe ato të ulëta e të mesme profesionale, do të mund të tërhiqeshin jo më tepër se 45,6 për qind e nxënësve që përfundonin arsimin e detyruar tetëvjeçar, respektivisht 23,3 për qind në shkollat 12 vjeçare dhe 12,7 për qind në teknikumet⁴. Kjo nënkuptonte që jo të gjithë nxënësit do të vijonin

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 490, viti 1966, dos. 51, fl. 5. Nga studimi i Ministrisë së Arsimit paraqitur Këshillit të Ministrave “Mbi përmirësimin e mëtejshëm të sistemit arsimor”.

⁴ *Po aty*, fl. 4-5.

arsimin e mesëm e atë të lartë dhe për rrjedhojë, një masë e konsiderueshme të rinjsh do të shkonin direkt në prodhim. Këto rrethana e shtynë udhëheqjen e vendit, të ndërmarrë masa të reja për ndryshime në sistemin arsimor me synim përgatitjen më të mirë të të rinjve për të marrë pjesë në punë. Brenda këtij kuadri u përpunuan disa opsione, të cilat, ndonëse në vështirimin e parë kanë dallim, në thelb përputheshin me një skemë të gatshme të përgatitur “nga lart”, që ndiqte hap pas hapi linjat e përcaktuara mbi bazën e të cilave do të ecej në këtë proces⁵.

Një platformë “e re” në këtë fushë i vinte për shtat para së gjithash partisë-shtet, pasi nga njëra anë mundësohej vënia më mirë në efikasitet dhe potencialit të sistemit arsimor ekzistues dhe nga ana tjetër, hapej rruga e thellimit të procesit të përshtatjes të sistemit të ndryshuar, interesave ekonomike dhe politikave të tij të zhvillimit. Gjithsesi në llogari të fundit, të gjitha këto ndryshime në rast se realizoheshin ishin të mirëpritura e të leverdishme edhe, për një pjesë të mirë të popullsisë. Një sistem arsimor më elastik parakuptonte më shumë mundësi shkollimi.

Lidhur me këtë problem, strukturat arsimore në bashkëpunim edhe me specialistë të njohur në fushën e shkollës, në verën e vitit 1966 u angazhuan në përgatitjen e një studimi të thelluar, që do t’i paraprinte ndryshimeve në sistemin arsimor. Studimi parashikonte dy variante që padyshim kishin plus minuset e tyre. Krahas argumenteve politike, silleshin edhe një varg arsyesh dhe nevojash sociale, ekonomike, shoqërore, arsimore e kulturore, që përligjinin nevojën e ndryshimeve në këto momente.

Sipas variantit të parë, sistemi arsimor ekzistues me disa plotësime mund të përballonte ngritjen e nivelit të përgjithshëm të shkollimit të popullsisë si dhe, përgatitjen e specialistëve të mjaftueshëm të ulët, të mesëm apo të lartë. Në mbështetje të këtij varianti silleshin disa argumente.

Së pari, sistemi arsimor i ndryshuar do të përfshinte një larmi tipesh shkollash për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar dhe të teknikëve të mesëm, të kontingjenteve të studentëve për shkollat e larta si dhe të specialistëve me arsim të lartë. Thjeshtësia e tij do të siguronte vijimësinë e atyre tipeve shkollash më të nevojshme për faza të caktuara, që mund të

⁵ Po aty.

përballonin kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe që lejonin ndërkohë, “eliminimin e të tjerave pa prishur unitetin e sistemit në fuqi”⁶.

Së dyti, sipas mendimit të hartuesve të studimit, karakteri unik që nënkuptonte një sistem të vetëm arsimor për të gjithë vendin siguronte lidhjen e ngushtë midis hallkave dhe, kalimin e lirshëm të nxënësve nga kategoritë më të ulëta në ato më të larta. Ndërkohë, ky karakter krijonte më tepër shanse që shtresat e ndryshme të popullsisë të rritnin nivelin e tyre të arsimimit.

Së treti, sistemi i ndërtuar dhe i konsoliduar në mënyrë graduale, dora dorës kishte krijuar një traditë të mishëruar në mënyrën e organizimit, përmbajtjes dhe metodat e përdorura, që nuk mund të anashkalohej.

Gjithnjë sipas variantit të parë, ndryshimet do të preknin disa anë të sistemit arsimor ekzistuese por, pa sjellë përmbysje. *Kështu shkolla 8-vjeçare edhe më tej konceptohej si baza e sistemit të arsimit, e përgjithshme dhe e detyrueshme*. Fakti që një pjesë gjithnjë e më e madhe nxënësish, pas përfundimit të saj do të futej në prodhim, kushtëzonte forcimin e përgatitjes së tyre për punë. Duke e parë problemin në këtë optikë, lindte nevoja e përmirësimeve në planet e programet shkollore, me synim rritjen e orëve të mësimit të punës. Për shkollat e fshatit parashikohej një shtim i orëve të mësimit të punës si dhe, përgatitjen bujqësore të nxënësve sidomos në klasat e larta. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në prodhimin bujqësor do të realizohej në përputhje me moshën, duke kaluar nga puna në kopshtin shkollor, në prodhimin e gjerë.

Përsa i takon shkollave 8-vjeçare të qytetit ekzistonte mundësia për forcimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet organizimit më të mirë të punës me dru apo metal, etj. Klasat e larta do të merrnin pjesë 2-3 javë në prodhim, pa pretenduar në marrjen e një profesioni apo të një kategorie pune. Mbi këtë bazë nxënësit fitonin gjithsesi një përgatitje të përgjithshme më të gjerë dhe me përfundimin e arsimit 8-vjeçar, mund të punonin në procese të thjeshta pune.

Gjithnjë brenda variantit të parë, përmirësimet do të preknin edhe arsimin e ulët dhe të mesëm profesional, të sistemit të ditës dhe atij të mbrëmjes. Nëpërmjet tyre do të mund të siguroheshin punëtorë të

⁶ *Po aty*, fl. 5-6. Studim i Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, paraqitur në Këshillin e Ministrave të RPSH “Mbi përmirësimin e mëtejshëm arsimor”.

kualifikuar të profesioneve masive. Lidhur me arsimin e mesëm profesional, sistemi ekzistues konsiderohej ende i përshtatshëm dhe efikas dhe në këtë kuptim, mendohej të qëndronte si i tillë edhe më tej. Pranimi i nxënësve në përmasa më të mëdha apo më të vogla, do të kushtëzohej gjithnjë nga nevojat e ekonomisë. Ndryshimet në këtë kategori shkollash do të konsistonin në orientimin drejt përgatitjes të teknikëve të mesëm me profil të gjerë, duke e vlerësuar si të papërshtatshëm dhe të paleverdishëm për ekonominë shqiptare, profilizimin e ngushtë. Tashmë tekniku i mesëm në prodhim, detyrimisht do të kryente për një periudhë një deri dy-vjeçare detyrën e stazhierit duke punuar si punëtor i kualifikuar dhe, me fitimin e një përvoje atë të drejtuesit të prodhimit⁷.

Shkolla e mesme e arsimit të përgjithshëm edhe më tej, do të kishte si destinacion kryesor përgatitjen e nxënësve për shkollat e larta dhe të punëtorëve të kualifikuar si edhe, atë të furnizimit me elemente të teknikumeve me bazë shkollën e mesme. Një ulje relative e sasisë së nxënësve që do të vijonin arsimin e lartë nga gjimnazet, mund të ndikonte në uljen e preferencës për këtë kategori shkollash. Por presupozohej që në shkallë absolute, përqindja e nxënësve në arsimin e mesëm të të gjitha kategorive do të vinte gradualisht në rritje. Sistemi i planifikimit të nxënësve për teknikumet përpos të tjerave, do t'i shtynte prindërit drejt përzgjedhjes të arsimit të mesëm të përgjithshëm, si një mundësi tërheqëse shkollimi për fëmijët e tyre, pavarësisht pranimi ose jo në arsimin e lartë, gjë që do të çonte dora-dorës në normalizimin e ritmeve të zgjerimit të gjimnazeve. Në perspektivën e shtrirjes të arsimit të mesëm të përgjithshëm në fshat, përcaktuese do të ishte sasia e nxënësve që do të mund të tërhiqeshin nga shkollat ekzistuese si edhe, nëpërmjet forcimit të sistemit të bursave e konvikteve, pranë shkollave të mesme të qyteteve.

I parë problemi në gjithë shtrirjen e tij, fakti që një pjesë e maturanëve nuk do të mund të vijonin arsimin e lartë, nxirrte më në pah kërkesën e forcimit në gjithë sistemin e arsimit të mesëm, të përgatitjes së nxënësve për punë. Një pjesë e mirë e tyre do t'i drejtohej prodhimit. Për momentin konsiderohej më e mundshme, forcimi i kësaj përgatitjeje për shkollat e rretheve bujqësore, ku kishte më tepër fronte pune. Për sa i takon qytetit, dhënia e një profesioni do të realizohej kur ekzistonin

⁷ *Po aty*, fl. 10-11.

kushte, duke mos e konsideruar në këtë fazë si një pikësynim të detyrueshëm për çdo shkollë.

Përmirësimet në arsimin e lartë do të konsistonin kryesisht në “forcimin e mëtejshëm të përgatitjes ideologjike të kuadrit të lartë”, që nënkuptonte një ndryshim të thellë të konceptit të këtij të fundit për punën. Nisen nga ky këndvështrim studimi parashtronte një kuadër të plotë masash. Kështu, parashikohej futja si element i ri në planet e programet e të gjitha shkollave të larta, i punës fizike që do të kryhej në kooperativat bujqësore apo ndërmarrjet industriale në formën e aksioneve nacionale apo lokale, me pjesëmarrjen edhe të pedagogëve. Të gjithë kuadrot e larta pas mbarimit të shkollës, për 1-2 vjet detyrimisht do të punonin në prodhim, duke iu nënshtuar “një procesi të vazhdueshëm edukimi në punë”⁸. Komplexiteti i problemit e bënte të domosdoshme pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në planet mësimore, me synim përmirësimin e raporteve teori-praktikë, në favor të këtyre të fundit.

Varianti i dytë, shtronte opsionin e një sistemi të ngritur mbi shkollën 8-vjeçare me vetëm një tip shkollash, ato profesionale të kategorisë së ulët e të mesme, ku do të përgatiteshin respektivisht punëtorët e kualifikuar dhe teknikët e mesëm. Shkollat profesionale mbeteshin njëheri edhe i vetmi burim i sigurimit të kontingjentit të studentëve për shkollat e larta, pasi shkollat e mesme të përgjithshme likuidoheshin. Brenda këtij varianti hidhej ideja e një arsimit të detyrueshëm 6-vjeçar, në vend të atij 8-vjeçar dhe, përfitimit në klasat e larta të elementëve dhe shkathtësive të para të një profesioni.

Si anë pozitive të variantit, të para këto nga këndvështrimi i interesave politike të momentit, konsiderohej zgjidhja në mënyrë të kënaqshme e problemit të përgatitjes “të të rinjve për jetën”, pajisja e tyre me një ose më tepër profesione, plotësimi në nivele të mjaftueshme i kërkuesve të ekonomisë e kulturës për specialistë etj. Studimi parashihte edhe disa “mangësi”, që sipas përkrahësve të tij nuk sfumimin epërsinë e këtij të fundit, në raport me variantin e parë. Gjithsesi, në rast se do të pranohej ideja që shkollat e mesme profesionale do të nxirrnin punëtorë të kualifikuar dhe se, vetëm ata më të dalluarit do të mund të bëheshin më vonë teknikë të mesëm, realisht e nxirrte këtë variant më pak të leverdisshëm. Në sistemin ekzistues punëtorët e kualifikuar përgatiteshin në shkollat e ulëta profesionale që kishin kosto më të ulët.

⁸ *Po aty*, fl. 16-17.

Kthimi i të gjitha shkollave të mesme në shkolla profesionale, nënkuptonte edhe investime të shumta për laboratorë, personel inxhiniero-teknik, baza materiale e didaktike, institucione të reja shkollore, të cilat nuk dihej në se mund të plotësoheshin në këto momente. Për më tepër, varianti vështirësonte përgatitjen e specialistëve të lartë në profilet humanitare, duke kufizuar ndërkohë të drejtën e çdo individi, për të përzgjedhur profilin që dëshironte. Po kështu kthimi i arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar në 6-vjeçar, realisht ishte një hap prapa në kushtet kur “tendenca e përgjithshme botërore” ishte ajo e rritjes, “të afatit të trungut të arsimit të përgjithshëm”⁹.

Në qershorin e vitit 1966 studimi u analizua në një mbledhje të veçantë të kryesisë së Këshillit të Ministrave ku mbizotëroi mendimi se, problemi i përmirësimit të mëtejshëm të sistemit arsimor ishte mjaft i rëndësishëm dhe me ndikim afatgjatë dhe për këtë, kërkonte edhe më tej “një studim të thellë dhe të gjithanshëm”¹⁰. Nisur nga ky fakt ka arsye të gjykohet se, cilido që mund të ketë qenë këndvështrimi i atëhershëm për ndryshimet e realizuara, një gjë ishte më se e qartë se ato, ishin të pamjaftueshme dhe se tashmë, ky përbënte një realitet që nuk mund të shpërfilllej.

Në pamje të parë zhvillimet e deriatëhershme në këtë fushë u vlerësuan si pozitive dhe “reforma arsimore që ne kemi bërë, do të shprehej kryeministri M. Shehu, në thelb është e drejtë, nisur nga baza të drejta pedagogjike dhe ideologjike, se përgatit njerëz për prodhimin. Defektin duhet ta kërkojmë jo në vetë sistemin, se sa në zbatimin e këtij sistemi”¹¹. Duke e parë nga kjo optikë, ai natyrisht do ta konsideronte atë si të përshtatshëm dhe me hapësirat e nevojshme për përmbushjen e kërkesave që shtronte zhvillimi i përgjithshëm ekonomik e shoqëror i vendit, ndërsa defektet si dobësi të rritjes. Ideja e transmetuar ishte se në thelbin e sistemit nuk do të kishte ndryshime dhe se ai do të ruhej por, lindte nevoja e ristrukturimeve dhe rregullimeve të pjesshme. Për një tjetër personalitet të lartë politik, A. Çarçani, zhvillimet e filluara duhej të çoheshin “deri në fund”, për të parë se çfarë do të sillnin edhe më vonë “në një fazë më të përparuar”, të ndërmerreshin “masa të reja”¹².

⁹ *Po aty*, Fondi 490, viti 1966, dos. 221, fl. 15.

¹⁰ *Po aty*, Fondi 14, viti 1966, dos.8, fl. 19.

¹¹ *Po aty*, Fondi 490, viti 1966, dos. 221, fl. 1. “Nga procesverbali i mbledhjes së kryesisë së Këshillit të Ministrave dt. 14.06.1966.

¹² *Po aty*, fl. 36. Diskutim i A. Çarçanit.

Në kuadrin e këtij diskutimi sipas proces-verbalit të mbledhjes, shumica e pjesëmarrësve ishin përkrahës të variantit të parë, që u përcaktua si më i mundshëm dhe më afër mundësive të shkollës shqiptare. Baza e shkollimit edhe për të ardhmen do të mbetej arsimit i detyrueshëm 8-vjeçar. Ajo çfarë ngjallte diskutime dhe që shënonte dallimin kryesor midis dy varianteve ishin çështje të tilla si: çfarë do të bëhej me nxënësit pas përfundimit të arsimit 8-vjeçar, a do të ruheshin të njëjtat raporte midis arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe atij profesional, si do të plotësoheshin nevojat në rritje të ekonomisë për punëtorë të kualifikuar dhe, nga cila kategori shkollash do të sigurohej numri kryesor i studentëve për arsimin e lartë etj.

Për sa i takon tërheqjes të të rinjve në arsimin e mesëm dhe atë të lartë, opinioni i shumicës ishte që për fshatin, kjo të realizohej nëpërmjet sistemit të bursave apo me shpenzimet e veta, por në ato përmasa që do të ishin mundësitë dhe në ato profesione që nevojiteshin. Për qytetin problemi ishte më i ndërlikuar sepse tashmë, vetëm një pjesë e nxënësve do të përfshiheshin në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional. Këtu nuk bëhej fjalë “për mësimin e një profesioni”, do të shprehte shqetësimin e tij personaliteti i njohur në fushën e arsimit, Rektori i Universitetit të Tiranës, K. Ylli “por ajo e përgatitjes të të gjithë nxënësve me edukatën e punës”¹³. Pyetja që shtrohej ishte se, çfarë do të bëhej me të tjerët që nuk do të vazhdonin studimet por do t’i drejtoheshin prodhimit dhe, a ishin ata të përgatitur për ta bërë këtë.

Pranimi i variantit të dytë, që ofronte opsionin e mbylljes së gjimnazeve dhe zëvendësimit të tyre vetëm me shkolla profesionale, nënkuptonte shkollimin e të rinjve vetëm nëpërmjet arsimit teknik. Ideja e politeknizimit të plotë të shkollës së mesme, sado interesante që mund të dukej, mendohej se nuk ishte zgjidhja më e mirë. Përpos të tjerave plotësimi i nevojave të ekonomisë me punëtorë të kualifikuar me arsim të mesëm, ishte i papërbalueshëm për kushtet e Shqipërisë në këto momente.

Duke sjellë shembullin e sistemit shkollor çek, ku rreth 75 përqind e drejtuesve të prodhimit ishin me shkollë 8-vjeçare apo atë të rezervave të punës, 15 për qind me gjimnaze dhe 10 për qind me teknikume, Ministri i atëhershëm i arsimit Th. Deliana do të mbronte argumentin që ishte më realist, se: “Në asnjë vend nuk është zgjidhur çështja e

¹³ *Po aty*, fl.20-21. “Nga procesverbalit i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të Ministrave” dt. 14.06.1966. Diskutim i K. Yllit.

përgatitjes së punëtorëve me teknike”, dhe se “do të ishte e lavdërueshme të arrihet që edhe punëtori të bëhet si tekniku i mesëm, por që të shtrohet detyra që kjo të bëhet masive, që me teknike të përgatiten punëtorë, sot për sot është e parakohshme”¹⁴.

Në kuadrin e diskutimit për ecurinë e mëtejshme të sistemit arsimor, një çështje e rëndësishme për të cilën u shprehën të gjithë në unison, ishte ajo e zhvillimit më të mirë të arsimit të ulët dhe të mesëm profesional. Ideja e likuidimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm nuk gjeti terren. Kështu u vendos që gjimnazet të ruheshin por, zgjerimi më i madh në të ardhmen do t’i takonte arsimit të ulët dhe të mesëm profesional. Në rrafshin praktik masat e ardhshme do të synonin ndryshime në planet dhe programet e këtyre kategorive shkollore dhe njëheri, forcimin e bazës materiale me synim marrjen e njohurive të mjaftueshme teorike dhe praktike për një profesion të caktuar.

Në këtë kontekst i jepej prioritet fuqizimit të arsimit të ulët profesional që shihej si burim i rëndësishëm për sigurimin e punëtorëve të kualifikuar aq shumë të nevojshëm për ekonominë e vendit. “Ne, do të linte të kuptonte gjatë diskutimit të tij ministri i arsimit Th. Deliana, mendojmë të zhvillohen akoma shkollat profesionale. Këto të bëhen të masës së rinisë edhe me anën e sistemit të mbrëmjes”¹⁵. Sipas K. Yllit “... sistemi i shkollave të ulëta profesionale të cilin ne duhet ta bëjmë masiv, të përfshijë shumicën e të rinjve të qyteteve”¹⁶.

Diskutimi mbi nevojën e përmirësimit të sistemit arsimor, evidencoi midis të tjerash faktin se, një nga arsyet e mosarritjes së “objektivave” ishin edhe disa mangësi e defekte në vetë ligjin për “Riorganizimin e shkollës”, të vitit 1963. Sipas nenit 12 të këtij ligji “shkolla e mesme e arsimit të përgjithshëm ka si detyrë të pajisë nxënësit me arsim të plotë të përgjithshëm dhe politeknik të nevojshëm, për të vazhduar shkollën e lartë dhe nëpërmjet mësimin të prodhimit dhe punës në prodhim, t’u japë nxënësve përgatitje profesionale në një nga degët e ekonomisë dhe kulturës popullore”. Po ashtu në nenet 19 dhe 23 thuhej shprehimisht se: “... në shkollat e mesme profesionale përgatiten teknike të mesëm për prodhimin si edhe për të ndjekur shkollat e larta”¹⁷.

¹⁴ *Po aty*, fl. 14. Diskutimi i Th. Delianës.

¹⁵ *Po aty*, fl.3. Nga procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të Ministrave, dt. 14.06.1966. Diskutimi i Th. Delianës.

¹⁶ *Po aty*, fl. 20. Diskutimi i K. Yllit.

¹⁷ *Po aty*, Fondi 14, viti 1966, dos. 18, fl. 39-40.

Formulimi taksativ i neneve të sipërthëna nënkuptonte që shkolla e mesme përgatiste vetëm elemente për shkollat e larta dhe ato të mesme profesionale, vetëm kuadro të mesme për të drejtuar prodhimin. Nëpërmjet riformulimit të këtyre neneve synohej që në të ardhmen, nxënësit që përfundonin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional, të ishin të përgatitur për të vijuar arsimin e lartë apo për të kryer punën e teknikut të mesëm, por edhe për të marrë pjesë “drejtpërsëdrejti në prodhim si punëtorë të kualifikuar”¹⁸.

*

* *

Masat për përmirësimin e sistemit arsimor

Studimi mbi perfeksionimin e sistemit arsimor u analizua nga Byroja Politike e KQ të PPSH në korrikun e vitit 1966, e cila vendosi marrjen e masave të shpejta në këtë fushë. Çuarja deri në fund e reformës për riorganizimin e shkollës, e parë kjo në prizmin e kërkesave të reja, mbetej pjesë e një strategjie që synonte të arrinte që të gjithë të rinjtë e të rejtat të merrnin “pjesë në punë prodhuese të çfarëdo lloji” dhe të edukoheshin “me punë”¹⁹.

Ajo çka i interesonte më tepër PPSH dhe që mbetej një synim strategjik në këtë fushë ishte forcimi i mëtejshëm i lëndëve politike dhe i koncepteve marksiste “mbi edukatën e punës”. Prioritet i gjithë sistemit të edukimit edhe për këtë fazë mbetej ruajtja dhe forcimi i karakterit politik.

Duke filluar nga hallkat më të ulëta shkollore, në ato më të larta, që sipas vetë liderit kërkonin në vazhdimësi “një vëmendje shumë të madhe, një studim serioz”, ndryshimet e reja do të bazoheshin detyrimisht në disa kriteret të përhershme bazë që do të ishin, “... kriteret politike, ideologjike, kulturore, ekonomike, të tëra të shikuara dhe të zgjidhura në prizmin e shkencave marksiste-leniniste” me pikësynimin e krijimit “të një sistemi edukimi të shumanshëm të njeriut tonë socialist, që ai gradualisht dhe pa ndërprerje të paiset me virtyte revolucionare”²⁰.

Një nga problemet që tërhoqi vëmendjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror gjatë analizës të këtij procesi, ishte ai i politeknizimit

¹⁸ *Po aty*, fl. 40-41.

¹⁹ *Po aty*, fl. 41.

²⁰ Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 33, Tiranë: 1981, f. 219. “Sistemin arsimor ta përmirësojmë duke u bazuar në kriteret...”. Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 14 korrik 1966.

të shkollës së mesme të përgjithshme, që konsiderohej si mjaft i mprehtë dhe që duhej trajtuar me kujdes. Ideja ishte se në kushtet kur nevojat e ekonomisë për punëtorë të kualifikuar vinin gjithnjë në rritje, përmeshja e tyre vetëm nëpërmjet arsimit teknik ishte i pamundur. Pavarësisht zgjerimit që pritej për këtë të fundit, sistemi i shkollave të mesme të përgjithshme mbetej një burim i rëndësishëm për sigurimin e tyre. Opsioni që u përzgjedh dhe që u quajt më efikas në këto momente ishte ai i forcimit tek nxënësit e gjimnazeve, i shprehive të punës si nëpërmjet ndryshimeve në planet e programet ashtu edhe nëpërmjet krijimit të fronteve të reja për realizimin e praktikave në prodhim.

Nxënësit duhej të angazhoheshin në çfarëdo fronti pune, kudo ku ekzistonin mundësi në industri, në ndërtim, në shërbime etj. Pjesë e këtij procesi do të ishte realizimi i punës fizike njëmuje kryesisht në bujqësi apo aksione. Në kuadrin e marrjes të një profesioni të caktuar të gjithë nxënësit e shkollave të mesme profesionale apo të larta, ishin të detyruar të kalonin një vit stazh drejtpërsëdrejti në prodhim dhe pastaj të diplomoheshin.

Në nëntorin e vitit 1966 zhvilloi punimet Kongresi i V-të i PPSH, i cili në fushën e edukimit, e rivlerësoi procesin e ndryshimeve në sistemin arsimor, si një nga drejtimet e rëndësishme të veprimtarisë së shkollës. “Për sa i përket sistemit tonë arsimor, do të evidencohet në raportin e Kongresit, krahas përcaktimit më të drejtë të përpjesëtimeve të zhvillimit dhe të rritjes së kategorive të ndryshme të shkollave, duhet t’u kushtohet kujdes i veçantë sidomos atyre hallkave shkollorë që i japin rinisë një përgatitje më të drejtpërdrejtë për jetën dhe punën. Për këtë qëllim duhet perfeksionuar sistemi arsimor ekzistues, duhen shfrytëzuar më mirë mundësitë që ai jep në këtë drejtim”²¹.

Thelbi i ndryshimeve edhe më tej do të konsistonte në marrjen tashmë të masave praktike për përmirësimin e elementeve bazë të sistemit arsimor. Tek e fundit, PPSH mbetej e interesuar para së gjithash për përgatitjen e të rinjve si “revolucionarë”, të brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste. I gjithë sistemi i përmirësuar duhej të siguronte një lidhje më harmonike të teorisë me praktikën, e mësimin me prodhimin. Bazuar në nivelin e përgjithshëm të shkollimit që realizohej gjithnjë nëpërmjet arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar, tashmë duhej të arrihej

²¹ Kongresi i Pestë i PPSH (përmbledhje materiale), Tiranë: “8 Nëntori”, 1966, f. 151-152.

vendosja e raporteve e përpjesëtimeve “më të drejta” midis, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe atij profesional, në favor të këtij të fundit.

Në këtë kuadër strukturat e larta shtetërore dhe ato partiake u angazhuan në përfshirjen sa më të gjerë të punonjësve të kësaj fushe në këtë proces. Ideja e ndryshimit ishte një lloj lajtmotivi i vazhdueshëm nëpërmjet të cilit PPSH vazhdonte të tërhiqte mësuesit dhe specialistët e arsimit të cilët në masën kryesore besonin sinqerisht në efektet pozitive të tij. *Ndër problemet e shtruar por që realisht nuk ishte i panjohur, ishte ai i mundësisë së fillimit të shkollës në moshën 6-vjeçare.* Për ta pranuar ose jo një opsion të tillë, një rëndësi të veçantë merrte analiza e thelluar e faktorëve ekonomikë e socialë, e gjendjes shëndetësore të fëmijëve, e veçorive të terrenit, e programeve më të përshtatshme për këtë grup moshe etj.

Në fundin e vitit 1966, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë angazhuan strukturat e tyre në rrethe, për mbledhjen e sa më shumë të dhënave, që do të ndihmonin në gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për kushtet e vendit tonë. Sipas një udhëzimi të përbashkët të të dy dikastereve, ato do të përpunoheshin nga një komision ku do të merrnin pjesë drejtuesit e shkollave, mësuesit, specialistët etj. Gjithnjë sipas udhëzimit, të dhënat do të kishin të bënin me sasinë e shkollave që vepronin në terrene të vështira, distanca më e largët nga vinin nxënësit, sa do të ndikonte pranimi i nxënësve 6-vjeçarë në zvogëlimin ose jo të rrezes së detyrimit shkollor, sa nxënës mund t'i shpëtonin këtij detyrimi, sa shkolla dhe mësues të rinj do të nevojiteshin për të mos ulur numrin e nxënësve në klasat e para, si paraqitej ecuria e nxënësve që kishin filluar shkollën në moshën 6-vjeçare, sidomos në nivelet më të larta të arsimit etj.²²

Pjesë e procesit u bënë dhe ekzaminimet shëndetësore dhe matjet antropometrike, të realizuara nga komisione të rretheve, me pjesëmarrjen e mjekëve, të 2000-3000 fëmijëve 6-vjeçarë në qytete dhe fshatra si në Shkodër, Tiranë (qytet), Gjirokastër, Elbasan, Korçë, Durrës etj.²³

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se për zgjidhjen e këtij problemi, në kushtet kur shkolla sovjetike nuk mund të përdorej më si model, u analizua ecuria e një procesi të tillë të ngjashëm në vendet e tjera. Në vendet fqinje dhe të rajonit si edhe disa të tjera me sisteme

²² *AQSh*, Fondi 511, viti 1967, dos. 3/128 shtesë, fl. 13. Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, dt. 16/12/1966.

²³ *Po aty*, fl. 75-76. Udhëzim i Ministrisë së Arsimit e Ministrisë së Shëndetësisë, dt. 16.01.1967.

arsimore të avancuara, mosha e pranimit në shkolla varionte në SHBA, BRSS, Jugosllavi, Rumani, Bullgari, 7 vjeç. Në Itali, Greqi, Francë, Belgjikë, Egjypt, Çekosllovakia 6 vjeç. Sipas statistikave botërore mosha e pranimit në shkollën fillore ndryshonte sipas tabelës²⁴.

Mosha e pranimit në fillore	Në sa shtete realizohet
5 vjeç	7
6 vjeç	55
7 vjeç	42
8 vjeç	4
6-8 vjeç	1

Mbi bazën e të dhënave rezultonte se, në pjesën më të madhe të shteteve, aplikohet fillimi i shkollës në moshën 6-vjeçare. Pyetja që shtrohet ishte, se a ishte kjo e mundshme për kushtet e Shqipërisë dhe në rast se po, cilat do të ishin rrjedhojat pozitive apo negative të aplikimit të kësaj mase. Nga korrespondencat e strukturave arsimore të rretheve rezulton një reagim i ndryshëm.

Rrethet me konfiguracion të thyer malor dhe zhvillim më të pakët arsimor në raport me të tjerët, e përcaktojnë prerazi, si një masë të parakohshme. “Me gjithë anët e mira, do të thuhej në relacionin e Pukës zonës më të thellë të vendit, që paraqet detyrimi i nxënësve 6-vjeçarë për të vazhduar shkollën fillore, dalin mjaft pengesa Në shumicën e fshatrave largësia mesatare është mbi 4 km dhe, në disa raste 5 km. Afërsisht rreth 60 për qind e nxënësve 6-vjeçarë në këto kondita nuk mund të detyrohen të vijnë në shkollë ... Po të shkurtohet rrezja e detyrimit, afërsisht 30 për qind e nxënësve të kësaj moshe do të mbeten jashtë detyrimit shkollor”²⁵.

Sipas mendimit të shprehur nga strukturat arsimore të disa rretheve me vështirësi terreni, kjo masë “do të ndikonte negativisht” në frekuentimin e rregullt dhe për rrjedhojë edhe në mbarëvajtjen e fëmijëve në mësim. “...Me propozimin e drejtorive të shkollave, do të thuhej në relacionin e Krujës, ne heqim nga detyrimi disa fëmijë të moshës 7-vjeçare ... kuptohet se sa e vështirë do të ishte kjo për 6-vjeçarët”.

Në informacionin e Kukësit një tjetër rreth malor i vendit, evidencohej fakti se, rreth 80 për qind e nxënësve udhëtonin shpesh 3-5 km në ditë, gjë që e bënte tepër të vështirë frekuentimin e rregullt të

²⁴ Po aty, Fondi 490, viti 1967, dos. 27, fl. 13.

²⁵ Po aty, Fondi 511, viti 1967, dos. 31/128 shtesë fl. 34.

tyre²⁶. Gjendja rëndohej edhe më tepër për disa arsye që nuk mund të anashkaloheshin. "... Gjendja shëndetësore e nxënësve, ushqimi jo i mirë, veshja jo e përshtatshme, lokalet shkollore jo shumë të ngrohta, do të vijohej në këtë informacion, na bëjnë ne si seksion arsimit, Drejtoritë e shkollave dhe komisionin që u aktivizua për këtë problem dhe prindërit të themi se, për kushtet e rrethit tonë pranimit i nxënësve në klasën e parë në moshën 6-vjeçare nuk duhet të praktikohet, mbasi tani për tani është i parakohshëm"²⁷. Në masën kryesore rrethet me zona të vështira malore ishin të mendimit, që mosha e pranimit në shkollën fillore të mbetej ajo shtatëvjeçare, madje një pjesë e tyre si Skrapari, Kukësi, Erseka, Burreli, Tepelena, Vlora, Peshkopia, Puka etj. e konsideronin të vështirë zbatimin e kësaj mase edhe për qytetin.

Nëpërmjet analizës së dokumentacionit evidencohet edhe një mendim tjetër, ai i mendësisë së zbatimit të diferencuar të kësaj mase, midis fshatit dhe qytetit apo zonave malore dhe atyre fushore. Argumentet e sjella ishin jo vetëm ato mbi vështirësitë e terrenit, por edhe për nivelin më të ulët kulturor të prindërve në fshat, si dhe për zhvillimin fizik dhe mendor të pamjaftueshëm të fëmijëve për të përballuar vështirësitë. Përpos këtyre, si do të evidencohet në disa informacione rrethesh "Prurja e nxënësve 6-vjeçarë në shkolla paraqet vështirësi të mëdha metodike dhe psikologjike siç janë programet e tanishme shumë të vështira dhe të ngarkuara për t'u përvetësuar nga një nxënës 6-vjeçar"²⁸.

Për sa i takon qyteteve dhe zonave fushore e kodrinore si Lezha, Tirana, Gjirokastra, Korça, Shkodra, Lushnja, Gramshi, Elbasani, Durrësi, Kruja, Fieri etj. mendimi i përgjithshëm ishte se fillimi i klasës së parë në moshën 6-vjeçare ishte i mundshëm. Ai mbështetej edhe në rezultatet e konsultave të organizuara me pediatër, mjekë psikologë e specialistë të arsimit që, zhvillimi fizik e psikik i fëmijëve nga pikëpamja mjekësore nuk përbënte pengesë. Fëmijët e të dy seksive në qytete, si dhe ata të kopshteve shkollore, ishin më të zhvilluar. Të dhënat e matjeve antropometrike të kryera në qytete dhe fshatra të Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Tiranës, Durrësit etj. tregonin se zhvillimi fizik i fëmijëve në gjatësi, peshë, kraharor ishte normal²⁹.

²⁶ *Po aty*, fl. 35.

²⁷ *Po aty*, fl. 81-82.

²⁸ *Po aty*, fl. 92.

²⁹ *Po aty*, Fondi 511, viti 1967, dos. 3/128 shtesë, fl. 104-105.

Në këto kushte Ministria e Arsimit filloi eksperimentimin e futjes në arsimin fillor të nxënësve 6-vjeçarë që në vitin shkollor 1966-1967. Eksperimenti përfshiu fillimisht pesë klasa (144 nxënës), në qytetin e Shkodrës dhe, 3 klasa në Burrel, një klasë të një fshati periferik të Shkodrës si dhe një klasë në një fshat gjysëm fushorë dhe gjysëm kodrinor në Burrel. Diktuar nga rrethanat, strukturat arsimore detyrohen të mbrojnë para instancave më të larta shtetërore dhe atyre partiake, opsionin e zbatimit gradual si dhe për të fituar kohë për përgatitjen ndërkohë të kuadrit të mjaftueshëm mësuesor dhe zgjerimin e institucioneve shkollore³⁰.

Pjesë e masave të ndërmarra në këtë periudhë tranzitore për rregullime në sistemin arsimor, ishin edhe ato për vijimësinë e hallkave shkollore mbi trungun e shkollimit masiv.

Problemi më i ndërlikuar dhe i diskutueshëm mbetej ai i arsimit të mesëm të përgjithshëm, që me gjithë përpjekjet nuk arrinte të jepte sa dhe si duhej, edukatën e punës. Në kushtet kur jo të gjithë ata që përfundonin gjimnazin do të përfshiheshin në arsimin e lartë dhe kur, një pjesë e mirë e tyre do t'i drejtohej prodhimit shqetësimi i strukturave shtetërore dhe atyre partiake erdhi në rritje. Ato mbeteshin thellësisht të interesuara për sigurimin para së gjithash, të një numri të mjaftueshëm punëtorësh të kualifikuar.

Në verën e vitit 1967 Ministria e Arsimit organizoi një anketim me mësues, prindër dhe specialistë të prodhimit për disa çështje si: a mund të gjendej një formë tjetër e organizimit të gjimnazit, cila mund të ishte ajo dhe cilat do të ishin përparësitë në raport me organizimin ekzistues, në rast se nxënësit në vitin e katërt të gjimnazit do të angazhoheshin në marrjen e një profesioni, cila do të ishte shkalla e kualifikimit të tyre, cili do të ishte vendi më i mirë ku kjo mund të realizohej, shkolla apo ndërmarrja etj.³¹

Nëpërmjet pyetësorit kërkohesh mendim jo vetëm për çështje të përgjithshme por edhe për ato specifike si p.sh. a do të ishte i mundshëm realizimi i programit mësuesor në 3 vite nëse viti i dymbëdhjetë do t'i kushtohej përgatitjes profesionale a mund të realizohej nga pikëpamja organizative, cila do të ishte struktura më e përshtatshme e vitit shkollor për të përfituar një arsim politeknik, njohuritë teorike për mësimin e

³⁰ *Po aty*, Fondi 490, viti 1967, dos. 27, fl. 14.

³¹ *Po aty*, Fondi 511, viti 1967, dos. 17, fl. 188-195.

punës do të jepeshin si lëndë të veçanta, apo nëpërmjet lëndëve të tjera si, fizika, matematika, kimia, nxënësit e qytetit në çfarë mase do të pajiseshin me njohuri bujqësore etj.³²

Nga të dhënat e grumbulluara rezultoi se në përgjithësi shumica e të anketuarve i përmbaheshin idesë të ruajtjes së gjimnazit, por me disa rregullime të pjesshme. Pjesa më e madhe e prindërve dhe e specialistëve të prodhimit u shprehën për një gjimnaz të shartuar me teknikumin dhe, një strukturë të re të vitit shkollor. Si elemente pozitive konsideroheshin harmonizimi i karakteristikave më të mira të të dy tipeve të shkollave të mesme, që garantonte një përgatitje më të mirë për në arsimin e lartë dhe, në mënyrë specifike përgatitjen në profesione masive si mekanik, bujqësi, ekonomi, teknologji etj. Ndër defektet më të rëndësishme konsideroheshin pakësimi i volumit të njohurive të përgjithshme, ngarkesa më e madhe në lëndët teknike si dhe, vështirësitë për sigurimin e një baze materiale të mjaftueshme³³.

Mbi këtë bazë në vitin shkollor 1967-1968 varianti u eksperimentua në 7 shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm. Për profilin bujqësor u caktuan 5 shkolla në Konispol, Himarë, Krutje, Kamëz dhe Koplík, për profilin mekanik një gjimnaz në qytetin e Durrësit dhe një për atë ekonomik në qytetin e Shkodrës³⁴. Regjistrimet në shkollat e shartuara ishin thuajse të njëjta me ato të gjimnazeve të tjera. Preferenca e prindërve dukej se nuk ndryshonte. Nisur nga këto konstatime strukturat arsimore shprehën mendimin se në sistemin e arsimit të mesëm për një periudhë afatmesme, mund të ecej me disa variante.

Gjithsesi, studimet e bëra, diskutimet dhe masat praktike të ndërmarra në këtë periudhë mbetën më tepër në fushën e eksperimentit. Zhvillimet e mëvonshme treguan se pavarësisht nga çka deklarohesh, ndryshimet në sistemin arsimor ishin të pjesshme dhe sipërfaqësore. Për rrjedhojë edhe rezultatet që prodhuan, ishin larg asaj çka pritej. Ato vetëm sa hapën siparin e ndryshimeve radikale që sollën aq shumë pasoja në ecurinë e mëtejshme të arsimit shqiptar.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*, Fondi 490, viti 1967, dos. 27, fl. 26-27.

³⁴ *Po aty*, fl. 27-28.

S u m m a r y

CHANGINGS IN THE ALBANIAN EDUCATION SYSTEM
IN THE THRESHOLD OF “SCHOOL BEING REVOLUTIONIZED”
(1966-1968)

The middle of the '60s introduced a new phase of further 'revolutionism' of school. During this phase, school underwent through a deep and complex reform, with a wide range of action and strong influence on the interior development of the whole education system and even further, of the Albanian society of that time. The years 1966 – 1968 represent a period during which the idea of this reform was framed and the fundamental lines of its theoretical platform were developed. Given the fact that one of the more important goals of the Communist government was the improvement of the education system, its attention focused precisely on that field.

Its aim was to achieve the preparation of a “new revolutionary generation” through partial transformation with specialists and laborers, sufficiently qualified to face the growing needs of the local economy. Studies and opened discussions on this issue were prepared in order to introduce the future modifications on the education system. From the lowest to the highest scholar levels, the progress would be, necessarily, based on some permanent basic criterions, which were political, ideological and economic, seen from the viewpoint of the creation of an education system that would further prepare “the new socialist man with versatile evolution”.

It must be admitted that the studies, the discussions and the practical measures taken during this period remain of an experimental level. The further evolution showed that the modifications on the educational system, independently from what was shown, were partial and superficial. Consequently, their results only made way for the radical evolutions, which had so many consequences in the further continuity of the Albanian education system, but were far from being what was expected.

